



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr.1093/5 Prot.

Tiranë, më 04.04.2018

V E N D I M

Nr.22, Datë 04.04.2018

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË 8 SUBJEKTE “MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË MASAVE TË REKOMANDUARA NË AUDITIMET E USHTRUARA NË ZVRPP-të”.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë 4 mujorin e III-të vitit 2016 dhe 9 mujori i I-rë vitit 2017, sipas programit të auditimit nr. 1093/1, datë 19.10.2017, në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Kryetarit nr.1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, rezultoi se:

Në 8 subjekte të audituar (ZVRPP Kukës, Devoll, Dibër, Kolonjë, Lezhë, Librazhd, Lushnje dhe Korçë dhe janë rekomanduar gjithsej 456 masa, nga të cilat janë pranuar 100 % e masave të rekomanduara. Nga këto janë zbatuar plotësisht 293 prej tyre ose 64.4% , janë pranuar 56 masa disiplinore, pjesërisht 1 masë dhe konsiderohen në proces zbatimi 88 masa ose 21.8 %. Masa të pazbatuara janë gjithsej 74 masa, të cilat përfaqësojnë 5 % të masave të propozuara gjithsej.

Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:

1. Masa organizative rekomanduar 341 masa, nga të cilat janë pranuar 341 masa ose 100 % e tyre, nga këto janë zbatuar 228 rekomandime, kanë nisur procedurat për zbatimin e 49 rekomandimeve dhe nuk janë zbatuar 64 masa organizative, kryesisht që janë të menaxhimit financiar dhe të arkivimit të dokumenteve në ZVRPP-të.

2. Masa shpërblim dëmi rekomanduar 59 masa, për vlerën 320,507 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 59 masa në vlerën 320,507 mijë lekë. Ku rezultojnë se janë zbatuar 6 rekomandime në shumën 16 mijë lekë, në proces zbatimi 40 masa për vlerën 197,545 mijë lekë, pa zbatuar 12 masa me vlerën e pa arkëtuar prej 106,962 mijë lekë .

3. Masa disiplinore rekomanduar 56 masa, nga të cilat janë pranuar 56 masa. Nga masat disiplinore të rekomanduara (pranuara) janë zbatuar plotësisht 7 masa, dhe nuk janë zbatuar 49 prej tyre.

Bazuar në këto rezultate të lidhura me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtori i Përgjithshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve,

vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm”, të ushtruar në subjektet e audituara në 4 mujorin e III-të vitit 2016 dhe 9 mujori i I-rë vitit 2017 .

II. Të rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

I. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) KUKËS.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Kukës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 71, datë 30.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 311/9 Prot , dt. 30.06.2016, konstatohet se: Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 64 rekomandime, nga këto: 54 masa organizative dhe **10 masa** zhdëmtimi me **vlerën 18,177 mijë lekë dhe 4 masa disiplinore**, nga të cilat: 1 masë “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për 2 punonjës dhe 1 masë për “Zgjidhje të kontratës së punës”, për 2 punonjës.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Kukës ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 2884 prot., datë 20.07.2016, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Kukës me shkresën nr. 544/1 prot datë 31.03.2017 i është kthyer përgjigje KLSH në përgjigje të shkresës nr. 1116/66 prot datë 19.01.2017 për zbatimin e rekomandimeve dhe kthim përgjigjen brenda 6 muajve.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve, është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 54 masa organizative, të cilat, janë pranuar 100% të asave dhe janë zbatuar 52 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 10 rekomandime në shumën 18,177,277 lekë, të cilat janë pranuar dhe janë zbatuar të pa zbatuara 1 rekomandim në vlerën 177,500 lekë, ndërsa 9 rekomandime në vlerën 18,000,000 lekë, janë në proces.
- c. Për masa disiplinore janë lënë: 1 rekomandim për “vërejtje me paralajmërim” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës” për 4 punonjës të cilat janë pranuar. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP ka dërguar shkresë në ZVRPP Kukës, dhe janë marrë 4 masa “vërejtje për largim nga puna”

Në përfundim, rikërkojmë nga ZVRPP Kukës, përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 311/9 Prot., datë 30.06.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara ose të zbatuara pjesërisht, konkretisht:

I. A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 22: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa për inventarizimin e dokumentacionit dhe të evadohen aplikimet e 112 praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara deri në vitet 2015, të analizohen të nxirren përgjegjësitë dhe të kthehen të ardhurat e përfituara pa kryer shërbimin e faturuar në vlerën **446 mijë lekë**. Kjo ka sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës në ZVRPP Kukës ndaj publikut, si dhe të administrohet në arkivën e institucionit dokumentacioni përkatës i praktikave, sipas tabelës “Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara shërbim prej përpara Vitet 2012- 2015”.

Rekomandim 33: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa për heqjen e kufizimit të pasurisë nr.41/39, volumni 28, faqe 146 , ZK 2315 Kukës që i përket zotit K. C, pasi ka parqajtur dokumentacionin e plotë tekniko ligjor.

Rekomandim 35: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, që në bazë të pikës “1” të nenit 5, pikës “1” të nenit 49 dhe neni 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** në ZK nr. 2315 për pasuritë nr. 22/145, volum 29, faqe 224; nr. 16/81ND, volum 19, faqe 28; nr. 16/75, volum 17, faqe 62; nr. 19/176, volum 27, faqe 92; nr. 46/143, volum 28, faqe 225; nr. 48/17, volum 27, faqe 60; nr. 50/242, volum 23, faqe 102; nr. 51/265, volum 29, faqe 88; nr. 51/119, volum 22, faqe 133; nr. 23/12, volum 29, faqe 73; nr. 40/120, volum 28, faqe 189; nr. 40/123, volum 28, faqe 205; nr. 48/97, volum 29, faqe 86; nr. 28/142, volum 29, faqe 140; nr. 35/169, volum 18, faqe 189; nr. 18/65, volum 29, faqe 113; nr. 34/149+1-2, volum 23, faqe 178 dhe nr. 50/199, volum 29, faqe 139, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

I. B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **18,177,277 lekë**, si më poshtë:

Rekomandim 1: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa organizative nr.4, më sipër), për masat e marra për zbatimin e procedurave dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë **426,309 lekë**, shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për **7 pasuri me sipërfaqe tepër +1919 m² tokë arë, vlerësuar me çmimin korent të kontratave dhe vendosur kufizimin e pronave deri në likuidimin e plotë të detyrimit**, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi të cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie ZK 1328 Bushat”.

Rekomandim 2: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (rekomanduar masa org. nr.6, më sipër), për masat e marra zbatimin e procedurave dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë **209,981 lekë** shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes

“shtet” dhe të vendoset kufizimi i pronave deri në likuidimin e plotë të detyrimit, pa titull pronësie për 4 pasuri me sipërfaqe tepër +3060 m² tokë arë të vlerësuar me çmimin korent të kontratave, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi të cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie ZK 2039 Kalimash”.

Rekomandim 3: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.9, më sipër), për masat e marra dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë **120,885 lekë** shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për 9 pasuri me sipërfaqe tepër +4704 m² tokë arë vlerësuar me çmimin korent të kontratave, **duke vendosur kufizimin e pronës deri në likuidimin e plotë të detyrimit**, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi të cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie ZK 2724 Morinë”.

Rekomandim 4: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.10, më sipër), për masat e marra zbatimin e procedurave dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë 649,350 lekë shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e pasurisë nr. 91/11 v.5 fq 235 zk. 2724 Morinë me sip 781 m² tepër +481 m² sipërfaqes tepër “shtet” truall pa titull pronësie nga qytetari L. I. D, vlerësuar me çmimin korent të kontratës, **duke vendosur kufizimin e pronës deri në likuidimin e plotë të detyrimit**, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi të cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie ZK 2724 Morinë”.

Rekomandim 5: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, **duke vendosur kufizimin e pronës objekt i këtij detyrimi**, për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **180,462 lekë** për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale **736 m²**, nga personat përgjegjës si më poshtë:

- z. **H. K**, me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën 123,169 lekë, për tjetërsimin e sipërfaqes prej 138 m²
- z. **R. K**, me detyrë ish-Regjistrues për vlerën 49,989 lekë, për tjetërsimin e sipërfaqes prej 313 m²
- z. **E. M**, me detyrë ish-Specialist për vlerën 7,307 lekë, për tjetërsimin e sipërfaqes prej 285 m².

Rekomandim 6: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 900,000 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit nr. 3, datë 12.11.2013 dhe bazuar në nenin 5.1, neni 49.1 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për pasuritë nr. 26/106, vol. 27, fq. 121, ZK. 2315-Kukës Qytet, nr. 35/47+1-9D, vol. 28, fq. 78, ZK. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, ZK. 2315-Kukës Qytet, **si dhe nxjerrjen e urdhrat të kufizimit deri në likuidimin e vlerës.**

Rekomandim 7: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **45,990 lekë** e ardhur nga tjetërsimi i pasurisë shtet, si dhe mos pagesa e taksës mbi vlerën shitjes, në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 33/45, vol. 17, fq. 139, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet, **duke nxjerrë urdhër kufizimi deri në likuidimin e vlerës.**

Rekomandimi 9: ZVRPP Kukës në 4 rastet sipas referencave nr. 019-0947, 050-0947, 053-0947, 053-944 më parë se të kërkohet arkëtimi i detyrimit prej 14,266,800 lekë dhe në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, germa “ç”, për pasuritë e regjistruara pa pasur AMTP të marrë masat e kufizimit deri në përcaktimin e statusit ligjor të pronësisë nga Bashkia Kukës

Rekomandim 10: Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 1,200,000 lekë, përkatësisht: 300,000 lekë për pasurinë nr. 40/120, volum 28, faqe 189; shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 23/108, volum 28, faqe 28; shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 26/92, volum 29, faqe 62 dhe shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 40/123, volum 28, faqe 205, deri në pagesën e plotë të vlerave.

Për të gjitha rekomandimet ku përfshihen dhe masat disiplinore që konsiderohen në proces zbatimi, të inkurajohet përshejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2018.

II. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) DEVOLL.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Devoll, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 608/10, dt.30.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë institucionit, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Devoll ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 1317/1, datë 17.10.2016, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, ZVRPP Devoll ka kthyer përgjigje me shkresën nr.106/1 prot., datë 06.02.2017, në përgjigje të shkresës së KLSH nr. 1116/68 prot datë 19.01.2017 për zbatimin e rekomandimeve dhe kthim përgjigje brenda 6 muajve.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 37 rekomandime gjithsej, nga këto: 36 masa organizative dhe 1 masë zhdëmtimi me vlerën 668,800 lekë, **13 masa disiplinore**, nga të cilat 1 masë “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për 11 punonjës dhe 1 masë për “Zgjidhje të kontratës së punës”, për 2 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 36 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe janë zbatuar plotësisht 36 rekomandime.

b. Për shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim për shumën 668,800 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar dhe janë të pa zbatuara, janë në proces.

c. Për masa disiplinore janë lënë: 1 rekomandim për “vërejtje me paralajmërim” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës” për 7 punonjës të cilat janë pranuar. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP, nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Devoll, për rrjedhojë konsiderohen të parealizuara.

Në përfundim; rikërkojmë nga ZVRPP Devoll, *përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara ose të zbatuara pjesërisht.*

II.B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi: ZVRPP Devoll në **3 raste** për katër subjekte të evidentuar në listat e shpronësimit, që nuk rezultojnë të kenë të regjistruar prona në KPP, të marrë masa për njoftimin e subjekteve dhe ndjekjen e hapave ligjorë deri në arkëtimin e detyrimit nga 4 subjektet evidentuar, për vlerën prej 668,800 lekë.

Për të gjitha rekomandimet ku përfshihen dhe masat disiplinore që konsiderohen në proces zbatimi, të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2018.

III. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) DIBËR.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Dibër, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit*”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin e Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 609/10, dt. 24.09.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, ZVRPP Dibër ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në mos zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për kthim përgjigje brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, ZVRPP Dibër nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga marrja e shkresës.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 68 rekomandime gjithsej, nga këto: 53 masa organizative dhe 13 masë zhdëmtimi me vlerën 110,086 mijë lekë, 2 masa disiplinore, nga të cilat 1 masa “Vërejtje me paralajmërim” dhe 1 masa për “Vërejtje deri në zgjidhje të kontratës së punës”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 53 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe zbatuar 22 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 10 rekomandime, ndërsa nuk janë zbatuar 21 rekomandime.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 13 rekomandime për shumën 110,086 mijë lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar, nga këto është zbatuar 1 rekomandim duke likuiduar detyrimin financiar 16410 lekë, gjithashtu janë zbatuar 4 rekomandime duke vendosur kufizim mbi pasuritë përkatëse dhe njoftuar bashkinë Dibër për masat që duhet të merren nga ana e saj për arkëtimin e detyrimeve financiare, është në proces zbatimi 1 rekomandim, ndërsa nuk janë zbatuar 6 rekomandime.

c. Për masa disiplinore janë lënë 1 rekomandim për “vërejtje” për 2 punonjës dhe 1 rekomandime për “Vërejtje” deri “Zgjidhje të kontratës së punës” për 4 punonjës të cilat janë pranuar. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP, nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Dibër, për rrjedhojë konsiderohen të përealizuara.

Në përfundim, rikërkojmë nga ZVRPP Dibër, *përshejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 609/10, dt. 24.09.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara ose të zbatuara pjesërisht.*

III. A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 1: ZVRPP Dibër në bashkëpunim me ZQRPP Tiranë të marrin masa për fillimin, ndjekjen e procedurave dhe përcaktimin dhe mbështetjen me fondet përkatëse të nevojshme për përfshirjen në sistemin e menaxhimit të regjistrimit fillestar të 14 fshatrave në zonat kadastrale me 1769 AMTP që përbëjnë 10% të Rrethit, si dhe të përfundojnë procesin e nisur të menaxhimit dhe futjes në sistem të ZK 2932 Qyteti Peshkopi, zonë me peshë kryesore, me synim rritjen e ritmeve të regjistrimit fillestar të pasurive pasqyruar në tabelën emërtuar *“Shtrirja e zonave kadastrale, gjendja në sistem, volumet, numri i KPP-ve dhe AMTP-ve, pasuritë bujqësore, trojet dhe numri progresiv i referencave të regjistrimeve në ZVRPP Dibër”*.

Rekomandim 2: ZVRPP Dibër të marrë masa të ndjekë në rrugë ligjore procedurat për vënien nën administrim në arkiv dhe të kërkojë nga Bashkia Peshkopi dhe nga NJQV-të përkatëse dorëzimin e AMTP-ve dhe tërë dokumentacionin e titujve të pronësisë të lëshuara nga Komisionet e Ndarjes së Tokës dhe Strukturat e Tjera që i përkasin 3 fshatrave të futura në sistem përkatësisht: *Begjunec Zk.1134;Pilafe Zk.2928, Rrashnapoje Zk. 3135, dokumentacion i munguar dhe që nuk administrohet fizikisht në arkivin e ZVRPP Dibër. pasqyruar në tabelën emërtuar “Shtrirja e zonave kadastrale, gjendja në sistem, volumet, numri i KPP-ve dhe AMTP-ve, pasuritë bujqësore, trojet dhe numri progresiv i referencave të regjistrimeve në ZVRPP Dibër”*.

Rekomandim 3: ZVRPP Dibër të marrë masa dhe të ndjekë në rrugë ligjore procedurat për vënien nën administrim në arkiv, të kërkojë nga Bashkia Peshkopi dhe nga NJQV-të përkatëse dorëzimin e Listave të trojeve 001 që u përkasin 40 fshatrave-Zk me 4936 K/Familjarë për 1 480 800 m² truall (llogaritur sipas normës) prej të cilave; për 26 fshatra-zk në sistem me mbi 3 131 K/familjare me sipërfaqe normë trualli 939 300 m² dhe për 14 fshatra-zk të pa përfshira në sistem me 1805 K/Familjarë me 541 500 m² paraqitur në tabelën *“Fshatra dhe zona kadastrale pa lista trojesh 001 të dorëzuara dhe të munguara në ZVRPP Dibër”*; dhe në tabelat emërtuar *“Gjendja e listave 001 të Trojeve e Zonave Kadastrale”* dhe tabelën *“Gjendja dhe administrimi i AMTP-ve dhe Listave 001 te Trojeve në Arkivin e ZVRPP Dibër”*.

Rekomandim 5: Regjistruesi i ZVRPP Dibër në bashkëpunim me Bashkinë Dibër të marrë masa, të identifikojë pasuritë e rregullojë gjendjen në KPP, të rakordojë dhe saktësojë listën e trojeve 001 me **138 K/Familjarë me 28890 m² truall (nga të cilët 11K/F kanë sipërfaqe tepër +1420 m² mbi normë dhe trajtuar me nga 2 troje), me gjendjen PIII dhe KPP-ve të çelura për 133 K/familjarë të pajisur me AMTP për sipërfaqen prej 1 122 744 m² tokë bujqësore dhe truall përfshirë në AMTP për 109 Kf me truall në sipërfaqen 29449 m² (mbi normë 7649 m² (29449-109 x 200), duke veçuar ndarë e regjistruar “shtet” sipërfaqen tepër norme, pasqyruar në tabelën emërtuar *“Tabela e kryefamiljareve dhe AMTP fshati Grazhdan ZK 1850 dhe evidentimi i trojeve Kol 6, Hyrë në sistem datë 20.4.2014”*.**

Rekomandim 11: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK.2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **6 636 538 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **19 552 800 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë

e llojit ndërtesa nga **26 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **1945 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën Tetor 2013-Nëntor 2014, të regjistruara pa marrëdhënie truall dhe me dokumentacion të parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin ; si dhe të njoftojë e ti kërkoje Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar “*Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2014*”.

Rekomandim 22: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, për të evidentuar, raportuar e relatuar gjendjen dhe regjistrimin e pasurive me mbivendosje, mbetur pa identifikuar e evidentuar disa vite radhë, si dhe të zbatojë procedurat e duhura ligjore për trajtimin e pasurive regjistruar me mbivendosje.

Rekomandim 27: ZVRPP Dibër të marrë masa për eliminimin e ndryshimit të zërit në 16 KPP KPP-të e çelura nga Njësia e Menaxhimit të Projektit për 13 rezervuar ndodhur në zonat e futura në sistem, ku për 2 rezervuar janë çelur 5 KPP, me ndryshime zërash kadastral përkatësisht: zëri “arë” me 18250 m² nga zëri “Rezervuar sipërfaqe Ujore” ku përfshin 11000 m² rezervuar, pra ndryshuar zëri kadastral, tej kompetencave,
- Të mbyll KPP pasuria nr. 449, v.2, f. 20 zk 2019, me sipërfaqe 1010 m²”Ledh””, që i përket Rezervuarit fshatit Kacni duke çelur KPP të re në sipërfaqen teknike të inventarit; si dhe të korrigojë gabimin në PIII të shprehur: “PIII pasuria nr. 449, v.2, f. 20 zk 2019, me sipërfaqe 1010 m² rezervuar Kacni, duke fshirë këtë dhe të hedhë saktë të dhënat e KPP me nr., vol., në zërin kadastral “Rezervuar sipërfaqe ujore” me emërtimin “Rezervuari Fshati Kacni “ dhe në sipërfaqen teknike sipas inventarit të Digave.

Rekomandim 30: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, për inventarizimin e dokumentacionit, identifikimin e tyre para viteve 2013 dhe të evadohen aplikimet e 66 praktikave dhe kërkesave në proces, të pa përfunduara prej 5 vitesh deri në vitet 2015. Të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht 300,1 mijë lekë sipas tarifave deri në 883 mijë lekë sipas Mandat arkëtimeve, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Dibër ndaj publikut, dhe të administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës i praktikave, sipas tabelës “Përmbledhëse e praktikave në proces para v. 2012 dhe periudha 2013-2015 ZVRPP Dibër”, dhe tabelës analitike “Praktika në proces të papërfunduara ndodhur tek specialistet deri vitin 2015”.

Rekomandim 32: ZVRPP Dibër të mos kryejë regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, lidhur me regjistrimin e titullit të pronësisë nga në përdorim që kanë qenë, duke kërkuar nga Bashkia, njësitë administrative të saj, plotësimin e dokumentacionit për procedurat e ndjekura në lidhje me përfitimit të titullit të pronësisë.
Të verifikohen në ZAMT të ish-Komunave Melan, Kala e Dodës, Luzni dhe Muhur, Qarku Dibër mbi zbatimin e procedurave ligjore të përfitimit të titullit të pronësisë për 27 rastet e nisura për regjistrim në ZVRPP Dibër, sipas shkresave të këtyre komunave.

Rekomandim 33: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK.2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **18,299,233 lekë** vlerë truall (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **29,003,930 lekë** nivel qeraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa nga **65 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **4970 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën për periudhën Janar - Dhjetor 2013, të regjistruara pa marrëdhënie truall dhe me dokumentacion të

parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin. Të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2014”.

Rekomandim 34: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të vendosë masë kufizimi mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve, në ZK. 2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **423,088 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM dhe vlera prej **359,600 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit pallat me leje ndërtimi dhe sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në 2011 mbi truall publik në sipërfaqen **124 m²**, për pasurinë nr. 14/225-ND, volum 26, faqe 47, dërguar për regjistrim te objekteve për vitin 2013, të regjistruara pa marrëdhënie trualli dhe me dokumentacion të parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin; si dhe të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore, rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2013”.

Rekomandim 35: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2932** për pasuritë nr. 9/137, volum 26, faqe 26; nr. 4/37, volum 26, faqe 40; nr. 12/133, volum 9, faqe 117; nr. 11/154 ND, volum 25, faqe 167; nr. 4/33/1, vërt hip nr. 215, datë 04.07.13; nr. 13/17, vërt hip nr. 29, datë 30.01.13; nr. 5/335, vërtetim hip. nr. 261, datë 06.08.13; nr. 22/44, vërt hip nr. 348, datë 06.08.13; nr. 22/269, vërt hip nr. 357, datë 16.09.13; nr. 22/214, vërt hip nr. 368, datë 03.10.13; nr. 23/83, vërt. hip nr. 369, datë 03.10.13; nr. 23/33, vërt. hip nr. 403, datë 03.10.13 dhe nr. 13/189, vërt. hip nr. 403, datë 03.10.13, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Rekomandim 36: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 1224** për pasuritë nr. 2/3, volum 3, faqe 45; nr. 166/5/1, volum 3, faqe 9; nr. 49/1, volum 3, faqe 6; nr. 49/2, volum 3, faqe 7; nr. 21, volum 1, faqe 223; nr. 32/2, volum 3, faqe 25; ZK nr. 1225, pasuritë nr. 54/1, volum 2, faqe 104; nr. 62, volum 1, faqe 72; ZK nr. 1320, pasuritë nr. 41/255, volum 6, faqe 23; nr. 4/1/3, volum 6, faqe 24; ZK nr. 2384, për pasuritë nr. 206, volum 2, faqe 83; nr. 60/32, volum 4, faqe 19; nr. 182, volum 2, faqe 160; nr. 229/1, volum 4, faqe 32; ZK nr. 1859, për pasuritë nr. 127/13, volum 1, faqe 72; nr. 4/3, volum 4, faqe 102 dhe nr. 4/4, volum 2, faqe 15, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Rekomandim 37: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2932** për pasuritë nr. 18/16, volum 26, faqe 44 dhe pasuria nr. 20/253, volum 26, faqe 92, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Rekomandim 38: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2932** për pasuritë nr. 2/3, volum 3, faqe 45; nr. 20/209, volum 26, faqe 150, nr. 28/41, volum 26, faqe 243, nr. 26/23, volum 27, faqe 11, nr. 24/83, volum 27, faqe 61 dhe nr. 35/271, volum 27, faqe 79, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Rekomandimi 40: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **të vendoset kufizim mbi pasuritë të cilat nuk janë tjetërsuar**, përkatësisht nr. 22/286, vol. 29, fq. 246, zk. 2932, nr. 22/288, vol. 29, fq. 248, zk. 2932 dhe nr. 24/85, vol. 27, fq. 197, zk. 2932 **deri në korrigjimin e vendimit të AKKP-së** në përputhje me aneksin nr. 1, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, ku sipërfaqet e oborreve në përdorim janë përcaktuar sipas nenit 6, të Dekretit nr. 7011, të vitit 1985.

Rekomandimi 42: Nga ZVRPP Dibër të merren masa që në çdo rast për kryerjen e regjistrimeve sipas listave të trojeve të kontrollohet nëse dokumentacioni i përcjellë për regjistrim, përmbush të gjithë elementët e formës dhe përmbajtjes të një dokumenti ligjor në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Rekomandim 43: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që të mos kryen veprime në kartela deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Dibër të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, si dhe në ato raste kur vërtetohet që është përfituar sipërfaqe mbi normën prej 300 m2, të shfuqizohen çertifikatat e lëshuara dhe veçimin e regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim, trajtuar në pasqyrat nr. 1, emërtuar “Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3942 Zimur Rrethi Dibër”, pasqyrën nr. 3, emërtuar “Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3566 Tartaj Rrethi Dibër” dhe pasqyrën nr. 4, emërtuar “Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3026 Popinare Rrethi Dibër”.

Rekomandimi 44: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, për identifikimin e **3 pasurive shtet**, si dhe të pasurive të tjera objekte shtetërore të paidentifikuara deri më tani, duke bërë shënimet përkatëse në kartelat e pasurive në përputhje me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Rekomandim 45: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e personave të cilët kanë përfituar më shumë se një pronë nga lista e trojeve, për zonën kadastrale 3942/Zimur, për pasuritë** si vijon: -Pas. nr. 311, vol. 2, fq. 40, -Pas nr. 314, vol. 2, fq. 171, -Pas nr. 300, vol 1, fq. 209, -Pas nr. 306, vol. 2, fq. 172, -Pas nr. 289, vol 2, fq. 45, -Pas nr. 323, vol. 2, fq. 46, -Pas nr. 246, vol. 2, fq. 176, -Pas nr. 293, vol. 1, fq. 191, -Pas nr. 218, vol 2, fq. 179, -Pas nr. 37, vol. 2, fq. 4 dhe -Pas nr. 135, vol 2, fq. 181, **deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Dibër të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991 dhe shfuqizimin e çertifikatave të lëshuara, veçimin e regjistrimin shtet të sipërfaqeve tepër në KPP, pa veprim tjetërsimi tek persona të tretë.**

Rekomandimi 48: Regjistruesi i ZVRPP Dibër bazuar në pikën “1” neni 5, pikën “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të marrë masa, **duke nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasuritë** nr. 148/9, volum dhe faqe e papërcaktuar në kartelë, zk. 3023 Pollozhan, regjistruar me Ref. 085, datë 15.02.2015, në pronësi të Z, M, R, A dhe O. E, si dhe pasurinë nr. 558/5, vol 5, fq. 2, zk. 2730, **deri në saktësimin e normës për frymë sipas certifikatës të gjendjes familjare të datës 01.08.1991 dhe veçimin e sipërfaqes tepër në shtet.**

Rekomandimi 49: Regjistruesi i ZVRPP Dibër bazuar në pikën “1” neni 5, pikën “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të marrë masa, **duke nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasuritë** nr. 148/3, vol. 3, fq. 66, zk. 3023, nr. 148/7, vol. 3, fq. 70, zk. 3023, nr. 819/19, vol 5, fq. 25, zk. 2730 dhe nr. 98/11, vol 3, fq. 7, zk. 3023 deri në plotësimin e dokumentacionit dhe saktësimin të normës për frymë sipas certifikatave të gjendjes familjare të datës 01.08.1991.

Rekomandim 51: Regjistruesi i ZVRPP Dibër **të nxjerrë urdhërin e vendosë masë kufizimi mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK. 2932 Qytet** dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **6,905,888 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **17,546,320 lekë** nivel qeraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa nga **38 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **2024 m²**, dërguar për regjistrim të objekteve në periudhën për periudhën Janar 2015-Dhjetor 2015. Këto janë regjistruar pa marrëdhënie me truallin dhe me dokumentacion të parregullt, **deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin.** Të njoftojë e kërkojë Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar *“Regjistrimi i lejeve të ndërtimit lëshuar në troje publike nga bashkia pa marrëdhënien e truallit dhe efekti i vlerës së truallit dhe vlera e qirasë së akumuluar, viti 2014”*.

Rekomandim 52: Regjistruesi i ZVRPP Dibër bazuar në pikën “1” neni 5, pikën “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të marrë masa, **duke nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor mbi pasuritë**, si vijon: - nr. 30/114, vol. 29, faqe 185, zk. 2932, - nr. 14/32/1, vol. 29, faqe 127, zk. 2932, - nr. 35/272, vol. 29, faqe 29, zk. 2932, - nr. 35/276, vol. 29, faqe 173, zk. 2932, - nr. 23/101, vol. 29, faqe 28, zk. 2932, - nr. 17/14, vol. 29, fq. 118, zk. 2932.

III B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Dibër, zbatimin e procedurave ligjore dhe kontraktore, (sa rekomanduar masa organizative nr. 11, më sipër) dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor nga të dy këto institucione për arkëtimin e dëmit ekonomik në **vlerën 26,189 mijë lekë** ndarë : **6 636 538 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **19 552 800 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa për **26 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **1945 m²**, dërguar për regjistrim të objekteve në periudhën tetor 2013-nëntor 2014, të regjistruara pa marrëdhënie truallin dhe me dokumentacion të parregullt; krahas sa rekomanduar për të nxjerrë urdhër të veçantë dhe vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK 2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të

pronësisë mbi truallin rrjedhur nga lejet e shesheve dhe nga dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave, paraqitur në tabelën emërtuar *“Regjistrimi i lejeve të ndërtimit lëshuar në troje publike nga bashkia pa marrëdhënien e truallit dhe efekti i vlerës së truallit dhe vlera e qirasë së akumuluar, viti 2014”*.

Rekomandim 4: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Dibër, zbatimin e procedurave ligjore dhe kontraktore, (sa rekomanduar masa organizative 33 sa më sipër) dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor nga të dy këto institucione për arkëtimin e dëmit ekonomik në *vlerën 47.303 mijë lekë* ndarë: *18,299,233 lekë* vlerë truall (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej *29,003,930 lekë* nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa për *65 leje* sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2013 mbi truall publik në sipërfaqen *4970 m²*, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën janar tetor 2013, të regjistruara pa marrëdhënie truall dhe me dokumentacion të parregullt; krahas sa rekomanduar për të nxjerrë urdhër të veçantë dhe vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK.2932 Qytet dhe në regjistrat hipotekorë deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin rrjedhur nga lejet e shesheve dhe nga dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave, paraqitur në tabelën emërtuar *“Regjistrimi i lejeve të ndërtimit lëshuar në troje publike nga bashkia pa marrëdhënien e truallit dhe efekti i vlerës së truallit dhe vlera e qirasë së akumuluar viti 2013”*.

Rekomandim 5: Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i shumës *763,362 lekë* për pasuritë trajtuar rast pas rasti.

Rekomandimi 7: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa për zhvendësimin e vlerës 56,350 lekë *regjistrim i vonuar krahas masës së kufizimit* për pasurinë nr. 148/3, vol. 3, fq. 66, ZK. 3023 dhe bazuar në pikën “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në likuidimin e vlerës së konstatuar.

Rekomandim 8: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të njoftojë e t’i kërkojë bashkisë Dibër, zbatimin e procedurave ligjore dhe kontraktore (sa rekomanduar masa organizative 51 sa sipër) si dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor nga të dy këto institucione për arkëtimin e dëmit ekonomik në *vlerën 24,452 mijë lekë* ndarë: *6,905,888 lekë* vlerë truall (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej *17,546,320 lekë* nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa nga *38 leje* sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 2004-2013 mbi truall publik në sipërfaqen *2024 m²*, dërguar për regjistrim të objekteve në periudhën Janar 2015-Dhjetor 2015, të regjistruara pa marrëdhënie truall dhe me dokumentacion të parregullt; krahas sa rekomanduar për të nxjerrë urdhër të veçantë dhe vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK. 2932 Qytet dhe në regjistrat hipotekore deri në likuidimin e detyrimeve ndaj bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin rrjedhur nga lejet e shesheve dhe nga dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave, paraqitur në tabelën emërtuar *“Regjistrimi i lejeve të ndërtimit lëshuar në troje publike nga bashkia pa marrëdhënien e truallit dhe efekti i vlerës së truallit dhe vlera e qirasë së akumuluar, viti 2015”*.

Rekomandim 9. Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 900,000 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejeve të përdorimit si dhe nxjerrjen e urdhrat të kufizimit në bazë të nenit 5.1, neni 49.1 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 *“Për Regjistrimin e Pasurive të*

Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 13/201-N1, vol. 29, fq. 10, zk. 2932 Dibër, nr. 13/200-N1, vol. 29, fq. 8, zk. 2932 Dibër dhe nr. 1/196-ND, vol. 29, fq. 21, zk. 2932 Dibër deri në likuidimin e vlerës.

Rekomandim 10: Regjistruesi i ZVRPP Dibër bazuar në nenin 5.1, neni 49.1 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, të marrë masat, për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 39,000 lekë e ardhur nga mos pagesa e tarifës për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja, **si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit** në mbi pasuritë nr. 12/207+1-4, vol 29, fq. 128, zk. 2932, nr. 12/207+1-5, vol 29, fq. 129, zk. 2932, nr. 12/206+1-4, vol 29, fq. 130, zk. 2932, nr. 11/175-N1, vol. 29, fq. 92, nr. 11/175-N2, vo. 29, fq. 93, nr. 11/175-N3, vo. 29, fq. 94, zk. 2932, deri në likuidimin e vlerës.

Për të gjitha rekomandimet ku përfshihen dhe masat disiplinore që konsiderohen në proces zbatimi, të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2018.

IV. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) KOLONJË.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Kolonjë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit*”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin e Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 284/7/11, dt. 03.07.2017, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, ZVRPP Kolonjë ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 1921, datë 28.07.2017, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në moszbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, ZVRPP Kolonjë nuk ka kthyer akoma përgjigje në KLSH sipas afatit, pasi nuk ka përfunduar afati 6 mujor i marrjes së shkresës.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 20 rekomandime gjithsej, nga këto: 19 masa organizative dhe 1 masë zhdëmtimi me vlerën 300,000 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 19 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe zbatuar 2 rekomandime, janë në proces zbatimi 12 rekomandime, ndërsa 5 rekomandime nuk janë zbatuar..*

b. *Për shpërblim dëmi janë lënë 1 rekomandime për shumën 600,000 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar, por nuk është zbatuar.*

c. *Për masa disiplinore janë lënë ... rekomandim për “vërejtje me paralajmërim” për x punonjës. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Kolonjë, për rrjedhojë konsiderohen të porealizuara.*

Në përfundim, rikërkojmë nga ZVRPP Kolonjë, përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 284/7/11, dt. 03.07.2017, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht.

IV.A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 3: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës a neni 25 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara në regjistrat hipotekor** nr. 248, nr. 249, nr. 250, nr. 251, nr. 252 dhe nr. 253, datë 19.12.2013; b) në hipotekë nr. 288, nr. 289 dhe nr. 289, datë 24.09.2014, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Rekomandim 4: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë në bashkëpunim me bashkinë Ersekë, të marrin masa për marrjen në dorëzim të pronave të transferuara me VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, si dhe regjistrimin në favor të tyre sipas dispozitave ligjore.

Rekomandim 5: Regjistruesi i ZVRPP në bashkëpunim me bashkinë Ersekë të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara të gjejnë zgjidhjet ligjore për të nënshkruar kontrata qiraje me përdoruesit, në të gjitha zonat kadastrale nën juridiksionin e saj, masë kjo që do të rrisë të ardhurat e bashkisë dhe administrimin e pronës publike. Për periudhën që personat e kanë shfrytëzuar të llogariten detyrimet dhe të kërkohet arkëtimi i tyre.

Rekomandim 6: Regjistruesi i ZVRPP Ersekë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** në ZK nr. 1594 për pasurinë e paluajtshme regjistruar në volum 8, fleta 94, nr. 1/52 me sipërfaqe 1400 m² truall, dhe ndërtesë 8,75 m² me pronar R N P, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 7: Regjistruesi i ZVRPP Ersekë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** në ZK nr. 1594, për pasurinë e paluajtshme regjistruar në pronësi të qytetarit S. M. R. me nr.8/85, volum 8, faqe 74 me sipërfaqe 500 m², me emërtim truall dhe 293 m² ndërtesë deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 8: Regjistruesi i ZVRPP Ersekë të marrë masa, në bazë të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të kërkojë zyrtarisht pranë institucioneve të lartpërmendura, gjetjen e rrugëve të ligjore të lirimit ose të dhënies me qira të pronave të okupuara për të gjithë ZK nën juridiksionin e saj.

Rekomandim 9: Regjistruesi i ZVRPP Ersekë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** në ZK nr. 1594 për pasurinë e paluajtshme regjistruar në pronësi të qytetarit K. H. S. ne vol 9 faqe 63 pasuria 259/27 për sipërfaqen 1519 m² dhe volum 9, faqe 64 për pasurinë 259/104 me sipërfaqe 1496 m², deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 10: Regjistruesi i ZVRPP Ersekë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** në ZK nr. 1594 për pasurinë e paluajtshme regjistruar në pronësi të qytetarit H. K. Sh. me nr. 230/71 në volum 7, faqe 74 me sipërfaqe 300 m² truall dhe 92.7 m² ndërtesë dhe J. K. Sh. duke

regjistruar pasurinë 230/72 volum 7, faqe 75 me sipërfaqe truall 300 m² dhe ndërtesë 92.7 m² deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 11: Regjistruesi i ZVRPP Ersekë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** në ZK nr. 1594 për pasurinë e paluajtshme regjistruar në pronësi të qytetares M. Dh. në KPP volum 5, faqe 232, është regjistruar pasuria nr. 7/116+2-3, apartament me sipërfaqe 76.79 m² deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 12: Regjistruesi i ZVRPP Ersekë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** në ZK nr. 1594 për zbatimin e Urdhër kufizimit nr146/prot, data 8.07.2014 për pasurinë e paluajtshme nr. 4003, e llojit truall me sipërfaqe 14000 m² dhe sipërfaqe ndërtese 996 m², e ndodhur në Kolonjë Leskovik, në pronësi të subjektit “C shpk” në vol 2, faqe 199, deri në plotësimin e dosjes së privatizimit dhe të konfirmuar nga AKP , për regjistrimin e spitalit termal “ S” sha, gent plani dhe planimetria.

Rekomandim 13: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës a neni 25 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e regjistruara në regjistrin hipotekor nr. 240, datë 19.12.2013, ZK 1948 Helmës, ZK 3083 Qafzezë, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 14: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës a neni 25 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 745, volum 3, faqe 224, 1948 Helmës, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 15: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës a neni 25 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë nr. 7, 10 a, 10 b, të regjistrimit hipotekor nr. 131, datë 18.02.2013, ZK 1251 Borovë, ZK 2273 Kreshovë, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 16: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës a neni 25 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e pasqyruara në nr. 1, 2, 3, 4, 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, 2430 Leskovik, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 17: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë: nr. 1/134-N1 volum 28 faqe 236, nr. 1/134+1-1 volum 28 faqe 237, nr. 1/134+1-2 volum 28 faqe 238, nr. 1/134+ 1- 3 volum 28 faqe 239, ZK 2430 Leskovik, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 18: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë nr. 461/4 volum 4 faqe 106, nr. 461/5 volum 24 faqe 219, nr. 536 volum 24 faqe 234, nr. 534 volum 25 faqe 52, nr. 461/2 volum 25, faqe 100, ZK 2430, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 19: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës neni 24 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi/ përmirësimi për pasuritë e pasqyruara në volumet për: ZK 1334, 3826, 3144, deri në nënshkrimin dhe vulosjen e plotë të (KPP)-ve për këto zona kadastrale.

IV. B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kolonjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, neni 39 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës totale 600,000 lekë përkatësisht për: Bordin e kullimit Korçë 300.000 lekë dhe Njësia Administrative ish-Komuna Qendër 300.000 lekë.

Për të gjitha rekomandimet ku përfshihen dhe masat disiplinore që konsiderohen në proces zbatimi, të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2018.

V. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) LEZHË.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Lezhë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit*”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 42, dt.30.04.2017 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 311/9 Prot , dt. 30.06.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, ZVRPP Lezhë ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, ZVRPP Lezhë me shkresën nr. 8545/1 prot datë 20.10.2017 i ka kthyer përgjigje KLSH në përgjigje të shkresës nr. 1116/66 prot., datë 19.01.2017 për zbatimin e rekomandimeve dhe kthim përgjigje brenda 6 muajve.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 54 rekomandime gjithsej, nga këto: 48 masa organizative dhe 6 masë zhdëmtimi me vlerën **12.294.559 lekë**.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 54 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe zbatuar 54 jan zbatuar 50, pa zbatuar 4.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 10 rekomandime për shumën totale **12.294.559 lekë lekë** të arkëtueshëm, janë në proces por të pa zbatuara plotësisht.

Në përfundim, rikërkojmë nga ZVRPP Lezhë, përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 311/9 Prot , dt. 30.06.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

V. A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë të marrin masa për evidentimin dhe inventarizimin e praktikave të pa futura në arkiv, duke nxjerrë përgjegjësinë ndaj shkaktarëve.

8.1. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë të marrë masa duke njoftuar Pushtetin Vendor (Bashkia Lezhë) për kompetencë trajtimi, të ri llogaritjes dhe arkëtimit të diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejen e ndërtimit për objektin e legalizuar, regjistruar në volum 27, faqe 113.

9. Gjetje: ZVRPP Lezhë në 74 raste, ka evidentuar pasuri me mbivendosje, por në asnjë rast nuk është regjistruar mbivendosje në kartelat e pasurisë së paluajtshme dhe në Seksionin “E” të kartelës, nuk është vendosur shënimi *“Ndalohen veprimet mbi pasurinë deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga mbivendosja”*, veprim në papajtueshmëri me pikat 2 dhe 3, neni 37, të ligjit nr. 33, datë 210.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, sipas tabelës Aneks nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 167-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë të marrin masa për evidentimin dhe saktësimin e pronave me mbivendosje, si dhe të përgatisë dokumentacionin në zbatim të kërkesave të nenit 37, të ligjit nr. 33, datë 210.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimit nr. 4 “Për fshirjen”.

10.1.Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë të marrin masa për marrjen në dorëzim të pronave të transferuara sipas VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 *“Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”*, si dhe regjistrimin në favor të tyre.

V. B. MASË PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje: ZVRPP Lezhë për 12 raste, të marrë masat për arkëtimin e vlerën 12,294,559 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit, që vijnë nga mos arkëtimi i të ardhurave nga tarifa e regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, nga mos llogaritja e tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit, për mos llogaritje të tarifës së taksës së kalimit të pronësisë për sipërfaqet e përbashkëta gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit, e përbërë nga:

- vlera prej 629,500 lekë duke u krijuar një dëm ekonomik, për buxhetin e shtetit për pasurinë nr. 1004/A, në volum 5, faqe 86, në ZK nr. 2568, del se është prerë aplikimi nr. 5400, datë 04.08.2016, me vlerë 11,000 lekë, ndërkohë që duhej të ishin prerë 78 regjistrime sipas akt kolaudimit janë 77 njësi të individualizuara, pra më pak 77 x 9000 lekë.

- vlera prej 635,460 lekë, sipas referencë nr. 0668, të regjistruar në hipotekë nr. 1040, datë 07.10.2013, për pasurinë nr. 3/74, në ZK nr. 3126, sipas aplikimit del se nuk janë prerë për çdo njësi të individualizuara dhe konkretisht për 14 njësi më pak prerje aplikim x 6500 lekë

/aplikimi =91,000 lekë dhe sipërfaqet të përbashkëta prej 777.80 m² të pa regjistruara me një vlerë prej 544,460 lekë.

- vlera 225.015 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për sipërfaqeve të përbashkëta prej 321.45 m² për hipotekë nr. 276, datë 19.06.2014, pasuria nr. 6/112 ND; subjekti “C-C” shpk

- vlera prej 325,000 lekë dëm ekonomik, në pa u prerë shërbimi i regjistrimit fillestar për 65 njësi të individualizuara me 5000 lekë secila = me kundërshtim me VKM nr. 576, datë 29.08.2012, për në hipotekë nr. 487, datë 18.09.2009, pasuria 5/43 dhe nr. 489, datë 18.09.2009, pasuria nr. 5/45;

- vlera prej 438,900 lekë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit sipas referencë nr. 1213, regjistruar në hipotekë nr. 281, datë 10.06.2015 të subjektit ndërtues “E. A.” shpk nuk janë regjistruar sipërfaqet e përbashkëta prej 627 m².

- vlerë prej 391,692 lekë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, sipas referencë nr. 1268, në hipotekë nr. 403, me nr. pasurie 3/116, në emër të investitorit V. Gj & L. S, nuk janë regjistruar sipërfaqet e përbashkëta prej 559,56 m².

- vlerë prej 1,997,100 lekë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, sipas referencë nr. 1262, në hipotekë nr. 39, datë 12.01.2016 në emër të investitorit “R” shpk, nuk janë regjistruar sipërfaqet e përbashkëta prej 2853 m².

- vlera prej 968,240 lekë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në emër të investitorit “V” shpk, me referencë nr. 6456, në ZK nr. 1987, fshati Ishull Shëngjin, nuk janë regjistruar sipërfaqet e përbashkëta për 1383.2 m².

- vlera prej 1,317,750 lekë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në emër të investitorit “F” shpk, me referencë nr. 6725, në ZK nr. 1987, fshati Ishull Shëngjin, nuk del që të jenë regjistruar sipërfaqet e përbashkëta për 1882.5 m².

- vlera prej 7,165,809 që përbëhet nga mos llogaritja e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 6,443,415 lekë dhe mos regjistruar sipërfaqet e përbashkëta për 1.033.5 m² të barabarta në vlerë prej 722,394 lekë, sipas referencë nr. 7041, në emër të investitorit “Alb Real” shpk, trajtuar me leje legalizimi 818169, datë 25.10.2016.

1.1.Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi bazuar në shkeljet e konstatuara dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës 12,294,559 lekë , për pasuritë trajtuara rast pas rasti në gjetjet, deri në arkëtimin e plotë të vlerës.

2.1. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për 7 pasuritë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e dëmit të shkaktuar, si vijon:

1.Pasuria nr. 4/201- ND, volumi 31, faqe 201, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “A” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 284,571 lekë, nga subjekti “A” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

2.Pasuria nr. 5/115, volumi 17, faqe 215, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “M. C.” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 1,094,660 lekë, nga subjekti “M.C.” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

3.Pasuria nr. 3/68, volumi 5, faqe 14, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “I-A” shpk, deri në arkëtimin e vlerës 157,500 lekë, nga subjekti “I-A” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

4.Pasuria nr. 6/281, volumi 21, faqe 228, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “L. A.” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 743,400 lekë, nga subjekti “L. A” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

5.Pasuria nr. 4/183, volumi 27, faqe 133, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “F” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 470,260 lekë, nga subjekti “F” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

6.Pasuria nr. 5/126, volumi 28, faqe 56, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “A. V. C.” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 665,000 lekë, nga subjekti “A.V C.” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

7.Pasuria nr. 6/289-Nd, volumi 23, faqe 10, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “L” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 1,035,440 lekë, nga subjekti “L” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

3.1.Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **të nxjerrë urdhër kufizimi bazuar në shkeljet e konstatuara për 4 pasuritë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e dëmit të shkaktuar për diferenca të paguara më pak për taksa dhe tarifa shërbimi**, si vijon:

1.Pasuria nr. 5/115, volumi 17, faqe 215, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “M. C.” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 463,000 lekë,

2.Pasuria nr. 3/68, volumi 5, faqe 14, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “I-A” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 142,500 lekë.

3.Pasuria nr. 6/281, volumi 21, faqe 228, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “L-A” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 139,000 lekë.

4.Pasuria nr. 5/126, volumi 28 faqe 56, ZK 8632, në pronësi të shoqërisë “A.V. C.” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej 180,000 lekë.

4.Gjetje: ZVRPP Lezhë në të gjitha raste e konstatuara nga auditimi rezulton se dokumentacioni për regjistrim, është pranuar nga specialistët por nuk kanë arkëtuar vlerën e kartelave të pasurive të paluajtshme në shumën 1000 lekë, çka përbën detyrim të pa arkëtuar, për shumën 381,000 lekë

4.1.Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **të nxjerrë urdhër kufizimi bazuar në shkeljet e konstatuara dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimi e shumës 381,000 lekë.**

- Sipas pasqyrës tarifa për kartelat e pasurisë së paluajtshme dhe regjistrim pasurie të pa arkëtuar për periudhën 01.01-2014 deri më 31.12.2016.

5.1.Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Lezhë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **të nxjerrë urdhër bazuar në shkeljet e konstatuara për referencat e paraqitura në vlerën 623,000 lekë**, për subjektet:

1. “L. N ” shpk, për sipërfaqen totale të përbashkët prej 123.06 m² në vlerën prej 86,142 lekë (123.06 m² x 700 lekë/m² ndërtim)

2. “B” ShPK “godinë polifunkionale 2 kate shërbimi + 8 kate banimi”, Lagja Vrosh Lezhë, sipas leje së zhvillimit nr. 4879 datë 06.11.2013, në vol 19 faqe 151-229, për sipërfaqen e 504.6 m² sipas plan rilevimit përgatitur për ndërtesë 628 m² me objekte pronësie 69, për të cilat nuk janë llogaritur detyrimet për tarifën e shërbimit në vlerën 113 000 lekë dhe sipërfaqja të përbashkët 89.3 m² në vlerën prej 62,510 lekë

3. “S. Gj. P.” ShPK sipas akt kolaudimit të përgatitur nga kolaudatori A. L. me nr. licence MK 1687, rezulton se sipas matjeve dhe verifikimeve në fakt planimetria e ndërtesës përbëhet nga 16 apartamente me sipërfaqe 2008.84 m².

ZVRPP nuk ka regjistruar në rubrikën “Përshkrimi i veçantë” dhe kornizën “Për pjesën e përbashkët” për pallatin në tërësi dhe për çdo aksesor të tij (apartament, shesh pushimi,

shkallë, ashensor, kabinë, depozita uji, sistem ngrohje etj} prandaj të llogariten detyrimet për pjesën e përbashkët dhe të ndjekë në rrugë ligjore detyrimin e rezultuar.

4. “E” ShPK, në lagjen Xhabija të objektit: “Qendër tregtare +8 kate banimi + papafingo”, Lagja Vrosh Lezhë, dhe pajisjen me certifikatë pronësie dhe hartë treguese të regjistrimit, për 5 njësi, 25 apartamente dhe 1 papafingo mes sipërfaqe të përbashkët 677,64 m² në vlerën 474,348 lekë .

6.1. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **të nxjerrë urdhër kufizimi bazuar në shkeljet e konstatuara dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pasuritë dhe arkëtimin e vlerave të mëposhtme:**

- Për shoqërinë “P” shpk, në vlerën prej 165,810 lekë;
- Për shoqërinë “F” shpk, në vlerën prej 422,700 lekë.

Për të gjitha rekomandimet ku përfshihen dhe masat disiplinore që konsiderohen në proces zbatimi, të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2018.

VI. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) LIBRAZHD.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Librazhd, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin e Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1329/12, datë 30.04.2017, konstatohet se:

Në zbatim të neni 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Librazhd ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 653/3, datë 23.05.2017, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në moszbatim të pikës 2, të neni 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Librazhd nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga marrja e shkresës.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 63 rekomandime gjithsej, nga këto: 49 masa organizative dhe 13 masë zhdëmtimi me vlerën 56,512,000 lekë, 1 masa disiplinore, “largim nga puna”, për 1 punonjës

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 49 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe janë zbatuar 49 rekomandime lidhur me vendosjen e kufizimeve.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 13 rekomandime për shumën 56,512,000 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar dhe janë të pa zbatuara lidhur me arkëtimin e detyrimeve financiare, janë në proces.

c. Për masa disiplinore janë lënë 1 rekomandim për “vërejtje me paralajmërim” për 9 punonjës dhe 1 rekomandime për “Zgjidhje të kontratës së punës” për 2 punonjës të cilat janë pranuar. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Librazhd, për rrjedhojë konsiderohen të pazealizuara.

Në përfundim, rikërkojmë nga ZVRPP Librazhd, përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1329/12, datë 30.04.2017, të cilat

nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht.

VI. B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1. Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa bazuar në shkeljet e konstatuara, për pasuritë 10/15-1, 5/66, “Ndërtesë+truall”, ZK 2446, Librazhd, regjistruar në KPP v. 11, faqe 152; v. 8, faqe 120, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, deri në arkëtimin e shumës 4,070,850 lekë, prej subjekteve pronarë të pasurive, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse të cilat kanë truallin në pronësi, nëpërmjet rrugës zyrtare. Në të kundërt detyrimi të likuidohet nga personat përgjegjës.

Rekomandim 2. Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara për pasuritë 1/93+1-1, 1/93, 1+1, 1/93+4-4, 1/93+2-2, 1/93+5-9, 1/93+5-9, 1/93+5-5, 1/93+6-6, 1/93+7-7, 1/93+8-8, 1/93+2-10, 1/93+3-11, “Ndërtesë+truall”, ZK 2446, Librazhd, regjistruar në KPP: Vol. 19, faqe 157, 156, 155, 158, 159, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 160, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, deri në arkëtimin e shumës 26,595,869 lekë, prej subjekteve pronarë të pasurive “Ndërtesë”+“Truall”, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse të cilat kanë pasuritë në pronësi. Në të kundërt detyrimi të likuidohet nga personat përgjegjës.

Rekomandim 3. Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë 8/228, 10/186, 1/295, 6/184, 8/83, 6/117, 4/6, 1/378, 1/359, 1/357, “Truall”, ZK 2446, Librazhd, deri në arkëtimin e shumës së përgjithshme prej 10 përfituesve, prej 4,395,753 lekë dhe transferimin e shumës në fondin për kompensimin financiar të ish-pronarëve, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse të cilat kanë pasuritë në pronësi, nëpërmjet rrugës zyrtare. Në të kundërt detyrimi të likuidohet nga personat përgjegjës.

Rekomandim 4. Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara për pasurinë 5/90-N1, “Ndërtesë”, ZK 2446, Librazhd, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, deri në arkëtimin e shumës 53,676 lekë, prej subjektit pronar pasurisë, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse të cilat kanë truallin në pronësi, nëpërmjet rrugës zyrtare. Në të kundërt detyrimi të likuidohet nga personat përgjegjës.

Rekomandim 5. Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara për pasuritë 143/30, 150/2/2, “Ndërtesë+Truall”, ZK 3203, “Rrajcë”, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, deri në arkëtimin e shumës 130,705 lekë, prej subjekteve pronarë të pasurive, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse të cilat kanë truallin në pronësi, nëpërmjet rrugës zyrtare. Në të kundërt detyrimi të likuidohet nga personat përgjegjës.

Rekomandim 6: Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës totale 1,305,000 lekë përkatësisht për: K.F.B Reparti Ushtarak 1810, 300.000 lekë, Njësia Administrative ish/ Komuna Qendër 300.000 lekë, Njësia administrative Ish/ Komuna Orenjë 405.000 lekë, Ali Fejza 300.000 lekë.

Rekomandim 7: Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës totale 5.601.960 lekë për Z K.

Rekomandim 8: Regjistruesi i ZVRPP Librazhd të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 5 bashkëlidhur këtij raporti auditimi, ZK 2446, deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur ligjor dhe shlyerjen e detyrimit në vlerën 64,349 lekë nga subjekti “I” shpk.

Rekomandim 10: ZVRPP Librazhd të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë evidentuar** në pasqyrën nr. 1, evidentuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi deri në përcaktimin e statusit ligjor të pasurive **për 11 subjektet** dhe arkëtimin e detyrimit prej **5,729,136 lekë**.

Rekomandim 11. ZVRPP Librazhd të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, **të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë 3/451 v.20, faqe 28 deri në paraqitjen e dokumentacionit të duhur ligjor dhe arkëtimin e detyrimit prej 8,357,490 lekë**.

***Komenti i subjektit:** Me urdhrin e kufizimi nr.77 datë 27.10.2017 është vendosur kufizimi si dhe njoftuar subjekti për detyrimin. Për pjesën e detyrimit subjekti ka lidhur kontratën e privatizimit nr. 1533 rep, 451 kol, datë 05.04.2017, për blerjen nga drejtoria e trajtimit të pronës publike Ministria e Financave, të trullit me sipërfaqe 60 m². Gjithashtu autorizimi për kryerjen e pagesës nr. 4322, prot datë 30.03.2017, konfirmoja bankare për blerje nr. 083 datë 30.03.2017. Referuar dokumentacionit e ndodhur në dosjen 8517 rezulton objekti ndërtesë në pronësi për pasurinë 3/389 volum 18 faqe 231 për të cilën është lëshuar certifikatë pronësie me datë 18.06.2009 në emër të K. D. është prishur me vendim të KRRT nr.4 datë 31.07.2009. Referuar dokumentacionin e ndodhur në dosje rezulton se me kontratën me nr. 1420 rep, 407 kol datë 28.05.1999 është bërë privatizimi dhe blerja e trullit me sipërfaqe 400 m² nga T. D.*

Koment:

Këto rekomandime konsiderohen të pranuar dhe të zbatuar sipas rekomandimit të lënë. ZVRPP Librazhd të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur, vlerësimin teknik ligjor të tij nisur nga fakti i plotësimit të rekomandimit të lënë për heqjen e kufizimit në përputhje me nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Rekomandim 12. ZVRPP Librazhd të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, **të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë 3/451 v.20, faqe 28 deri në paraqitjen e dokumentacionit të duhur ligjor në lidhje përcaktimi në marrëdhëniet të pronësisë dhe arkëtimin e detyrimit të llogaritur për sipërfaqet e përbashkëta prej 10,500 lekë**.

Rekomandim 13, ZVRPP Librazhd të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të **nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 7/135, v.21, faqe 177 deri në paraqitjen e dokumentacionit të duhur ligjor dhe arkëtimin e detyrimit të llogaritur**, për sipërfaqet e përbashkëta dhe taksës së ndikimit në infrastrukture në vlerën prej **196,803 lekë**.

-Këto rekomandime konsiderohen të realizuara, pasi kanë dalë urdhrat e kufizimit dhe janë vendosur kufizimet për të gjitha pasuritë sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, për

rrjedhje do të mbeten të kufizuar deri në plotësimin e parregullsisë të konstatuara nga auditimi i KLSH-së. ZVRPP Librazhd në bashkëpunim me institucionet përkatëse, duhet të vazhdojë procedurat, duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë, për arkëtimin e detyrimeve financiare, përcaktuar sipas rekomandimeve përkatëse të lëna nga KLSH.

Për të gjitha rekomandimet ku përfshihen dhe masat disiplinore që konsiderohen në proces zbatimi, të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2018.

VII. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) LUSHNJE.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Lushnje, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin e Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën përkatëse, konstatohet se:

Në moszbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Lushnje nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, nga marrja e shkresës, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në moszbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Lushnje nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga marrja e shkresës.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 52 rekomandime gjithsej, nga këto: 45 masa organizative dhe 5 masë zhdëmtimi me vlerën 82,986,345 lekë, 2 masa disiplinore, nga të cilat 1 masë “vërejtje me paralajmërim”, për 13 punonjës dhe 1 masë për “vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për 3 punonjës..

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 45 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe zbatuar 12 rekomandime, janë në proces zbatimi 17 rekomandime, ndërsa nuk janë zbatuar 16 rekomandime..

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 11 rekomandime për shumën 82,986,345 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar, nga këto është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim duke vendosur kufizim mbi pasurinë, nuk është arkëtuar detyrimi financiar, 5 rekomandime nuk janë zbatuar.

c. Për masa disiplinore janë lënë 1 rekomandim për “Vërejtje deri në largim nga puna” për 11 punonjës dhe 1 rekomandime për “Zgjidhje të kontratës së punës” për 3 punonjës. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Lushnje, për rrjedhje konsiderohen të përealizuara.

Në përfundim, rikërkojmë nga ZVRPP Lushnje, përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën përcjellëse, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht.

Rekomandim 2: Regjistruesi i ZVRPP Lushnje të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në rastet e

konstatuara më sipër në ZK nr. 8572, për pasuritë e përfituara me AMTP, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 6: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që të inventarizohen dhe çelen dosjet përkatëse për 78 kërkesa për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore të KVVTP drejtuar ZVRPP, duke kthyer shkresat origjinale në arkiv dhe për 12 kërkesa për të cilat nga ana e ZVRPP Lushnjë nuk janë kthyer përgjigje në shkëlqje të afateve ligjore, të zbatohen procedurat dhe të fillojë pasqyrimi në KPP deri në zgjidhjen e plotë ligjore për regjistrimin e pasurive bujqësore, të kthimit të përgjigjeve, të pasqyrohen ngjarjet në KPP dhe të bëhet bllokimi i transaksioneve.

Rekomandim 8: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë në bashkëpunim me Bashkitë Lushnjë dhe Divjakë të bëjnë identifikimin e pasurive dhe pronave të transferuara sipas VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, si dhe regjistrimin në favor të këtyre Bashkive.

